



Prishtinë, 29 mars 2018
Kodi i ZRRE-së: V_941_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_866_2016 të datës 25 nëntor 2016 të lëshuar shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Wind Park Selac 2, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Wind Park Selac 2, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Mitrovicës, të datës 06.11.2017, të shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., me adresë: rruga e "Mujo Ulqinaku" nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_866_2016 i datës 25 nëntor 2016, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Wind Park Selac 2, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Mitrovicës edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me **25 maj 2018**.
- II. Shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Wind Park Selac 2, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Mitrovicës, gjegjësisht deri me datën **25 maj 2018** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur në pikën I. të dispozitivit, Vendimi V_866_2016 i datës 25 nëntor 2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 14.07.2016 nga shoqëria **“SOWI KOSOVO” L.L.C.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Wind Park Selac 2, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, Komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 25 nëntor 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_866_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_866_2016, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 12 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë **“SOWI KOSOVO” L.L.C.**, do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Aplikuesi **“SOWI KOSOVO” L.L.C.**, me datë 06.11.2017 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: *kompania “SOWI KOSOVO” L.L.C., ka vazhduar me zhvillimin e projekteve në Bajgorë, me theks të veçantë në përmbushjen e kërkesave të ZRRE-së, ku deri më tani i ka pranuar pëlqimet mjedisore për projektet e ndryshme nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe është duke e negociuar versionin final të marrëveshjes për kyçje në KOSTT, ka punuar projektet e zbatimit dhe ka siguruar dëshmitë financiare për realizimin e projekteve. Gjithashtu ka theksuar se për shkak të zhvillimeve të fundit në vend dhe ndryshimeve të fundit brenda projektit dhe në pajtim me kornizën ligjore në Republikën e Kosovës, ka kërkuar që të lejohet shtyrja e afatit për dorëzimin e dokumenteve sipas kërkesës dhe obligimeve që rrjedhin nga procedurat zyrtare të përcaktuara në Kosovë.*
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë **“SOWI KOSOVO” L.L.C.**, për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së